



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1254 (31026-00609-83-2016)
Dt. Rregj. 06.06.2016

Nr. Vendimi 771 (682)
Dt. Vendimi 24.11.2016

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana Liti, sot me datë 24.11.2016, ora 10.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 1254 (31026-00609-83-2016) datë 06.06.2016 që I përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS:

Peroni fizik Albana Margjeka, rregjitruar ne rregjistrin tregtar QKR, me date 11.07.2007, me nr. Nipt-I K78127505L, e perfaqesuar nga Adminitratorja Znj. Albana Margjeka e datelindjes 28.01.1977, e lindur ne B.Curri, Tropoje dhe banuese ne Lezhe , e identifikuar me karte identiteti me nr.H75128050S, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe me nr.kontakti +355694725789 per qellim njoftimi zyrtar per gjykatën.

E PADITUR:

Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, perfaqesuar nga Z.Izidor Frashni i autorizuar per perfaqsim me autorizim nr. 37085/1 Prot, datë 17.11.2016

Dega Rajonale e Tatimeve Lezhë, perfaqesuar nga Z. Izidor Frashni I autorizuar per perfaqsim me autorizim nr. 20587 Prot, datë 23.11.2016

Me pjesmarrije të:

Avokatura e Shtetit Tiranë (në mungesë).

OBJEKTI:

Kundershtim i vendimit te Drejtorise se Apelimit tatimor me nr.39245/2Prot, I dates 29.02.2016. anulimi I gjobes ne Shume 100.000 (njemije) Leke sipas aktit administrativ " Njoftim Vlersimi Detyrimi Tatimore" , me nr.6399 Prot I dates 01.10.2015 I nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne

Republiken e Shqipërisë" I ndryshuar. Nenet, 7. 11. 15. 17. 18. 40. 41 e vijues te ligjit 49/2012 " Per Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative". neni 107. 108. 109. 116. 121 te Kodit te Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi palën paditëse e cila u shpreh për pranimin e kërkesë padisë, përfaqësuesin e palës së paditur z. Isidor Frashni, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesë padisë si të pa mbështetur në ligjë dhe në prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se:

Paditesja Person Fizik Albana Margjeka i është drejtuar gjykates administrative shkalle e pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale e Tatime Lezhe dhe DPT -Tirane me objekt;

Kundershtim i vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor me nr.39245/2 Prot, date 29.02.2016.

Anullimi i gjobes ne shumen 100.000 (njqind mije) lek, sipas aktit administrativ "Njoftim Vleresim Detyrimi Tatimor", me nr.6399 Prot., date 01.10.2015, i nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe.

Rrethanat e faktit;

Ne akt-konstatimin e mbajtur date 10.09.2015, eshte cituar :

-Gjate verifikimit u konstatuan 2 punonjes ne subjekt perkatesisht Selim Margjeka me Nr ID F40510084B dhe Arber Margjeka me Nr ID I70222098F.

Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhe, bazuar ne Akt-konstatimin e mbajtur nga inspektoret e kontrollit ka vendosur gjoben ne shumen 100.000 leke(2x50.000) per mosdeklarim te dy punonjesve te pa identifikuar, bazuar ne nenin 119, pika a, te ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", (i ndryshuar) sa me poshte :

Neni 119 parashikon se; *"Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendondodhjen e biznesit, rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor, cdo te punesuar rishtazi, te pakten 24 ore perpara fillimit te punes,detyrohet te paguaje nje gjobe prej 50.000 (pesedhjetë mije) lekesh kur eshte subjekt i biznesit te vogel dhe 500.000 (peseqind mije) lekesh, per biznesin e madh me Tvsh, per cdo rast mosdeklarim".*

Me "Njoftim Vleresim Detyrim Tatimor" me nr.6399 Prot., dates 01.10.2015, i nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe, eshte vendosur gjobe ne shumen 100.000 (njqind mije) Lek,vendim te cilin paditesja e ka ankimuar ne drejtorine e apelimit e cila me vendimin me shkresen nr 39245/2 prot., date 29.02.2016 ka vendosur:

Lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 100.000 (njqind mije) Leke,percaktuar ne aktin administrativ "Njoftim vleresimin per detyrim tatimor", me nr.6399 Prot i dates 01.10.2015 , te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe.

Paditesja brenda afatit ligjor ka ushtruar ankim ne gjykatën administrative shkalle e pare Shkoder .

Ne gjykim paditësja ka parashtruar se;

Me date 10.09.2015, dy punonjes te sherbimit prane Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe kane ushtruar kontroll sipas akt- konstatimit me nr. 0515035 ne ambientin tim te

punes dhe aty jane gjendur babai im Selim Margjeka (pensionist) dhe vellai Ar. Margjeka, te cilat jane detyruar te hapin ambientin per te dorezuar nje ore tek nje klient qe kishte kohe pa e marre. Prezenca e tyre ne ambientin tim te punes nuk ka patur arsye tregtare, por vetem i kushtezuar nga gjendja ime e rende shendetesore per periudhen 06.09.2015 deri 22.09.2015 (koheqendrimi im ne shtetin grek per arsye shendetesore), ata jane detyruar pas insistimit edhe te klientit tim per te marre ne dorezim oren e riparuar me kohe prej meje, te hapin ambientin dhe t'i pergjigjen klientit. Ne zbatim te nenit 111/4 te ligjit nr. 9920 "Per Procedurat tatimore ne RSH", pala e paditur duhet te kishte arsyetuar se jemi para situates gjoba tatimore konkrete duhet te hiqet sepse moszbatimi i legjislacionit tatimor eshte shkaktuar nga nje semundje e rende e tatimpaguesit, sepse mosprezenca e saj ne aktivitet per shkak te nevojës per trajtim ne shtetin Grek ka sjelle qe familjaret e saj te kryejne veprime ne shkelje te legjislacionit tatimor.

Semundja e rende e tatimpaguesit Albana Margjeka provohet nga shkresa e Spitalit te Pergjithshem te Athines (diagnoza), ku theksohet se kjo shtetase vuan nga "OTITIS AKUT I MESEM" dhe se pacientja ka nevojë per konsulta te shpeshta. Gjithashtu provohet nga faturat tatimore me nr. 6172 dhe nr. 1393 se Albana Margjeka ka kryer analiza klinike dhe endoskopi ne Athine me date 07.09.2015. Keto fakte jane me se te mjaftueshme per te provuar se ekziston shkaku ligjor per te faktuar se jemi para situates ku gjykata duhet te vendose te hiqet gjoba e kundershuar per shkak se veprimet qe jane kryer ne kundershim me legjislacionin tatimor, jane kryer te ndikuara nga semundja e rende e tatimpaguesit, cka ka sjelle mungesen e saj ne ambientet e punes. Per sa mesiper kerkojme pranimin e padise sipas objektit.

Ana e paditur prapsoi;

Ne akt-konstatimin e mbajtur, date 10.09.2015, me perfaqesues Z. Selim Margjeka, eshte cituar :

-Gjate verifikimit u konstatuan 2 punonjes ne subjekt, perkatesisht; Selim Margjeka me Nr ID F40510084B dhe Arber Margjeka me Nr ID I70222098F".

Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhe, bazuar ne Akt-konstatimin e mbajtur nga inspektoret e kontrollit ka vendosur gjoben ne shumen 100.000 leke, (2x50.000) per mosdeklarim te dy punonjesve te pa identifikuar, bazuar ne nenin 119, pika a, te ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", (i ndryshuar).

Bazuar ne piken 5, neni 108 te Ligjit nr. nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" dhe piken 108.5 te udhezimit ne zbatim te tij, ne proceduren e ankimit, barra e proves per vertetuar se nje vleresim tatimor apo vendim eshte i pasakte, bie mbi tatimpaguesin.

Pretendimet e paditeses se me date 6.09.2015 - 22.09.2015 ka udhetuar drejt Greqise per arsye shendetesore dhe se gjate kesaj periudhe lokali ka qene i mbyllur, ndersa me daten 10.09.2015, nje klient i cili kishte lene oren per riparim, ka kerkuar terheqjen e saj, prandaj familjaret babai dhe vellai i tatimpagueses i jane pergjigjur per ti dhene oren e riparuar, nderkohe qe ne ambientin e aktivitetit kane hyre per kontroll inspektoret tatimore duke evidentuar dy personat e familjes, nuk jane bindese per anen e paditur, per pasoje nuk jemi ne kushtet e nenit 111 pika 4 I ligjit 9920/2008. "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar), ne te cilin citohet:

Pika 4. "Gjobat e vendosura per shkelje tatimore administrative mund te hiqen ne rrethana te jashtezakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor eshte shkaktuar nga fatkeqesi natyrore apo rrethana te tjera, te jashtezakonshme, si vdekja ose nje

sëmundje e rende e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron ne perputhje me udhezimet me shkrim te administrates tatimore".
Per pasoje kerkojm e rrezimin e kerkese padise.

Gjykata vereren se;

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë ka bere vlerësimin e aktit te kostatimit ku subjekti rezultoi ne shkelje te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise" i ndryshuar si dhe udhezimit nr.24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise" i ndryshuar, nenit 119," Mosdeklarimi i punonjesve" dhe nenit 122 Kundervajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale, per instalimin e paisjes fiskale.

Ne nenin 119 citohet se :

Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar rishtazi, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per cdo punonjes te padeklaruar si me poshte:

- a) Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobe prej 500 000 (peseqind mije) lekesh.
- b) Tatimpaguesit e tjere, me gjobe prej 50 000 (pesedhjete mije) lekesh.

Referuar rrethanave te faktit rezulton e provuar se punonjesit e konstatuar ne pune ne momentin e kontrollit Selim Margjeka me Nr ID F40510084B dhe Arber Margjeka me Nr ID I70222098F, jane familjaret e tatimpagueses Albana Mamargjeka (babai dhe vellai) dhe se eshte provuar gjate gjykimit qe ate dite ato gjendeshin ne aktivitetin e paditeses per ti dhene porosin nje klienti (oren e tij te riparuar dhe te pa terhequr).Gjetja e tyre ne aktivitetin e paditeses nuk ishte per te ofruar sherbim sipas llojit te aktivitetit qe ajo ushtron por, per te dorezuar nje porosi, pasi kjo nisur nga natyra e vacante e aktivitetit "ore ndreqes", provohet se eshte e lidhur me cilesite e vacante te vete individit si ne rastin ne gjykim te tatimpagueses Albana Margjeka dhe, kete lloj aktiviteti nuk mund ta kryejne persona te tjere qofshin dhe familjaret e saj, pasi nuk i kane keto cilesi, per pasoje gjykata krijon bindjen se familjaret e paditeses nuk ishin per pune (sic dhe jane shprehur ne akt konstatim ana e paditur) por, per te dhene porosine e pa terhequr nga klienti.

Nga ana ligjore referuar provave, paditesia ka provuar mbi baze prove se me date 6.09.2015 - 22.09.2015 ka udhetuar drejt Greqise per arsye shendetesore.

Semundja e saj provohet nga shkresa e Spitalit te Pergjithshem te Athines (diagnoza) ku theksohet se kjo shtetase vuan nga "OTITIS AKUT I MESEM" dhe se pacientja ka nevojë per konsulta te shpeshta. Gjithushtu provohet nga faturat tatimore me nr. 6172 dhe nr. 1393 se Albana Margjeka ka kryer analiza klinike dhe endoskopi ne Athine me date 07.09.2015. Gjate kesaj periudhe lokali ka qene i mbyllur, ndersa me daten 10.09.2015, nje klient i cili kishte lene oren per riparim, ka kerkuar terheqjen e saj,prandaj jemi ne kushtet e nenit 111 pika 4 te ligjit 9920/2008. "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise" (i ndryshuar),ne te cilin citohet:

Pika 4. "Gjobat e vendosura per shkelje tatimore administrative mund te hiqen ne rrethana te jashtezakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor eshte shkaktuar nga atkeqesi natyrore apo rrethana te tjera, te jashtezakonshme, si vdekja ose nje sëmundje e rende e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron ne perputhje me udhezimet me shkrim te administrates tatimore".

Per sa mesiper ndryshe nga sa arsyeton ana e paditur ne gjykim, gjykata vlereson se jemi ne rastin e parashikuar te nenit 111 pika 4 te ligjit 9920/2008, te cilen e perjashton tatimpaguesin nga shkeljet e konstatuara.

Perfundimisht gjykata e gjen kerkimin e paditeses te mbeshtetur ne prova dhe ligje dhe vendos pranimin e saj dhe meqenese vlera e aktit administrative qe kundershtohet eshte me e vogel se 20 fishi i pages minimale ne shkalle vendi, konform nenit 45/b te ligjit 49/2012, ky vendim eshte I formes se prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40,41 ,42, 45/b të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nenit 126,306 dhe 310 të K.pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin aktit administrative, "Njoftim Vleresim Detyrimi Tatimor", me nr.6399 Prot i dates 01.10.2015 , i nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe.

-Shfuqizimin aktit administrative vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor me nr.39245/2 Prot, date 29.02.2016.

-Shpenzimet gjyqesore sic janë bërë.

-Ky vendim është I formës së prerë, përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë .

- Kundër vendimit nuk lejohet ankim .

Shkodër me datë 24.11.2016

SEKRETARE SEANCE
Borana LITI



GJYQTARE
Valbona DURRAJ

